



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.10.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FUSHË
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i Ekipit Igballe Halili dhe Anëtarëve të ekipit Abdurrahmon Berbatovci dhe Arnisa Aliu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve parapraka	29
Shtojca III: Letër konfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Theksim i Çështjës

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për subvencione në vlerë 425,135€ dhe për mallra dhe shërbime në vlerë 114,507€, ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale;
- Vlera e pasurisë e shpalosur në pasqyrat financiare nuk ishte e saktë; dhe
- Detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare, ishin nënvlerësuar për 144,624€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e pasqyrave financiare vjetore. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna kishte ekzekutuar pagesa nga kodi i investimeve kapitale, në vlerë totale prej 425,135€¹ të cilat i përkasin kategorisë subvencione dhe transfereve si dhe vlerën 114,507€² që i takojnë kategorisë mallra shërbime. Këto shpenzime ishin buxhetuar dhe aprovuar si investime kapitale, megjithatë nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si të tilla;
- Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë investimet në vijim në vlerë 144,648€, të cilat ishin bërë për ndërtimin dhe renovimin e disa shtëpive për banim social. Mos regjistrimi në regjistrat e pasurisë ka rezultuar që pasuritë mbi 1,000€ të nënvlerësohen. Po ashtu, pasuritë jo kapitale (nën 1,000€) ishin nënvlerësuar për 20,665€; dhe
- Në PFV, detyrimet kontingjente janë shpalosur bazuar në raportin e avokatit komunal. Megjithatë, ne kemi identifikuar se vlera e detyrimeve kontingjente e paraqitur në raportin e avokatit nuk ishte e saktë pasi që, dy padi ishin nënvlerësuar për vlerën 188,584€, ndërsa dy padi tjera, në vlerë 43,960€ që kishin përfunduar, ende ekzistonin në raport. Si rrjedhojë e kësaj, në përgjithësi detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 144,624€ të cilat njëjtë janë reflektuar edhe në PFV. Për më tutje, nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të paditësve, komuna pritet të ketë vështirësi financiare.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

¹ "Ngritja dhe përkujdesja sociale shëndetësore" në vlerë 220,163€; "Folie plastike" në vlerë 14,160€; "Ndërtimi i serave" në vlerë 33,925€; "Spërkatëse për traktor" në vlerë 6,400€; "Laktofriza" në vlerë 11,130€; "Moto kultivator" në vlerë 75,476€; "Blerja e pulave vojse" në vlerë 251€; dy pagesa "Mekanizëm bujqësor" në vlerë 48,629€; "Përzierëse mulliri" në vlerë 15,000€.

² "Pastrimi i rrugëve gjate sezonit dimëror" në vlerë 54,900€; "Trajtimi i qenve endacak" në vlerë 14,937€; "Shpenzimet për akomodimin-Art-Harilaçi" në vlerë 3,440€; "Material stomatologjik" në vlerë 5,999€; "Festivalit Visions of Beyond" në vlerë 2,980€; "Blerja e lendeve djegëse-Dru" në vlerë 15,000€; "Eliminimi i deponive të egra" në vlerë 9,796€; "Projektit D.D.D" në vlerë 7,455€.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve; dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë, dhe planin e prokurimit.

Përpos çështjeve të theksuara të opinionit të auditimit ne kemi identifikuar gabime si:

- Tek raporti i ekzekutimit të buxhetit, në kolonën e buxhetit final, buxheti i ndarë nuk ishte prezantuar drejtë në vlerë totale sipas SIMFK-së, megjithatë, dallimi është sqaruar poshtë tabelës së ekzekutimit të buxhetit. Kjo situatë është reflektuar edhe tek shpalosjet e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, neni 14.6;
- Obligimet ishin nënvlerësuar në vlerë prej 2,203€; dhe
- Numri i të punësuarave me kontratë për shërbime të veçanta nuk ishte prezantuar saktë. Në PFV ishin prezantuar 61 punëtorë, mirëpo të punësuar gjatë vitit ishin 58 punëtorë.

Megjithatë, marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari, duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale, si dhe në evidentimin dhe raportimin e pasurisë dhe obligimeve.

Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi ka të vendosur sistem të mirë të kontrolleve në raport me obligimet statutores të saj. Megjithatë, edhe me tutje mbesin disa fusha të cilat kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Derisa kontrollet mbi realizimin e të hyrave dhe investimeve duhet të shtohen me qëllim që komuna të realizojë ato në një përqindje më të lartë kundrejt mundësive të saj. Përveç kësaj nevojitet një përqendrim më i shtuar i komunës në parandalimin e ekzekutimit të pagesave direkte nga thesari.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: planifikimi i buxhetit dhe i shpenzimeve për kategori ekonomike, përfshirë klasifikimin adekuat të shpenzimeve, menaxhimin e kontratave, menaxhimin e obligimeve dhe të arkëtueshmeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,540,837	11,376,373	8,544,687	8,210,069	8,268,351
Granti i Qeverisë -Buxheti	6504,864	6,565,272	6,491,101	6,261,168	6,399,365
Të bartura nga viti paraprak ⁴ -	-	1,631,762	904,444	659,656	793,102
Të hyrat vetjake ⁵	3,035,973	3,035,973	1,072,629	1,181,936	1,055,547
Donacionet e brendshme	-	130,343	63,534	69,309	-
Donacionet e jashtme	-	13,023	12,979	38,000	20,337

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁴ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,835,536€. Ky ndryshim është si rezultat i rritjes së grandit qeveritar, i donacioneve të brendshme dhe të jashtme, si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 75% të buxhetit final, me një rënie prej 8% krahasuar me vitin 2016. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,540,837	11,376,373	8,544,687	8,210,269	8,268,351
Pagat dhe Mëditjet	4,373,544	4,433,952	4,433,952	4,405,372	4,266,183
Mallrat dhe Shërbimet	604,568	672,952	662,379	714,238	707,486
Shërbimet komunale	150,000	150,000	149,925	149,710	169,390
Subvencionet dhe Transferet	274,675	430,041	362,657	383,933	389,231
Investimet Kapitale	4,138,050	5,689,428	2,935,774	2,557,016	2,736,061

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 60,408€, reflektohet nga vendimi i qeverisë;
- Për kategorinë mallra dhe shërbimet kishte rritje për 68,384€. Rritja e buxhetit përfshinte të hyrat e bartura në vlerë 55,384€ dhe nga donacionet në vlerë 8,000€ nga Republika Çeke për projektin “Pajisje tjera”, ndërsa nga Qeveria Zvicerane është bërë pagesë direkte në vlerë 5,000€ për projektin “ Renovim i shtëpive të komunitetit REA”;
- Te subvencionet dhe transferet kishte rritje për 155,366€. Rritja e buxhetit përfshinte të hyrat e bartura në vlerë 25,022€ dhe donacionet e brendshme, në vlerë 130,343€; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale kishte rritje nga të hyrat e bartura në vlerë totale 1,551,378€. Pavarësisht rritjes së buxhetit për projekte kapitale, niveli i realizimit të buxhetit ishte vetëm 52%.

Çështja 2 – Niveli i ulët i realizimit të buxhetit si dhe keq-klasifikimi i shpenzimeve

E gjetura Procesi i menaxhimit të buxhetit nga komuna ka qenë mjaft sfidues. Marrë parasysh periudhën fiskale, një përqindje e madhe e shpenzimeve është realizuar në fund vit. Në anën tjetër, ka ngecje në realizimin e projekteve kapitale e cila reflekton edhe në realizimin e buxhetit, në vetëm 52%. Arsyet për një ekzekutim të ulët ishin kryesisht vonesat nga drejtoritë kërkuese për të përgatitur dokumentacionin teknik të projekteve individuale. Sipas zyrtareve komunal, për shkak të rritjes së numrit të banorëve në komunën e Fushë Kosovës, është shtuar vëllimi i punëve në të gjitha drejtoritë, gjë që ka afektuar negativisht në efektivitetin e punëve të komunës.

Çështje e rëndësishme është edhe ekzekutimi i buxhetit nga pagesat direkte të thesarit sipas vendimeve gjyqësore në vlerë 184,720€. Përveç këtyre kishte edhe klasifikim jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike (shih nënkaptullin 2.1).

E gjetura Planifikimi fillestar jo i duhur dhe mos kryerja e obligimeve me kohë rrisin rrezikun që objektivat e përcaktuara të komunës mos të arrihen. Po ashtu, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike ndikon në paraqitjen jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi 2 Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve, që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Ndërsa, planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 2,024,666€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, taksat administrative, etj. Gjithashtu komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e trafikut dhe gjobat në vlerë 235,362€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,035,973	3,035,973	2,024,666	2,262,738	2,288,351
Totali	3,035,973	3,035,973	2,024,666	2,262,738	2,288,351

Për vitin 2017, komuna, ka inkasuar 67% të te hyrave të planifikuara. Për shkak të rritjeve të kufijve buxhetor për të hyrat vetjake, këtë vit krahasuar me vitin paraprak reflekton në inkasim më të ultë.

Çështja 3 - Mos verifikimi i pronave të regjistruara

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin (ri anketimin) e 1/3-tës së pronave të paluajtshme siç kërkohet me Ligjin për Tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Sipas regjistrit të tatimit në pronë, komuna ka 15,750 prona komunale të regjistruara, ndërsa gjatë vitit 2017 nuk ka ndonjë raport mbi numrin e verifikimit të pronave.
- Rreziku** Mos verifikimi i pronave për qëllime të tatimit në pronë rrezikon që komuna të mos ketë informata të mjaftueshme në bazën e të dhënave. Kjo do të ndikojë negativisht në vlerësimin dhe faturimin e tatimit në pronë dhe si rezultat nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.
- Rekomandimi 3** Kryetari, duhet të sigurojë se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë.

Çështja 4 - Mangësi në menaxhimin e pronave publike

- E gjetura** Nga testimi i listave të 58 shfrytëzuesve të pronës publike (dhënien e banesave kolektive me qira në fshatin Miradi e Epërme) vetëm 15 familje ishin pajisur me kontrata. Nga gjashtë mostra të testuara vërejtëm se kontratat nuk janë valide në aspektin e periudhës kohore. Megjithatë, pronat shfrytëzohen ende pa ndonjë vendim zyrtar apo ripërtëritje të kontratës.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve adekuate dhe veprimi me kohë nga komuna lidhur me shfrytëzimin e pronës publike rritë rrezikun që këto prona të keqpërdoren, dhe mjetet e parapara të mos inkasohen asnjëherë.
- Rekomandimi 4** Kryetari, duhet të ndërmarr masat që sa më parë t'i pajisë qiramarrësit me kontrata për shfrytëzimin e pronave, në mënyrë që të kenë bazë ligjore për inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e tyre.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, si dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit bëhet në bazë të rregullores së brendshme për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 822,952€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 812,304€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja 5 - Angazhimi përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta

- E gjetura** Dy pozita të rregullta të punës (njek dhe mësimdhënës), që nuk kishin të bënin me punë specifike, komuna i kishte mbuluar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Komuna, për këta të punësuar kishte aplikuar procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore, pas rekomandimit të dhënë në fazën e ndërmjetme.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat.
- Rekomandimi 5** Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore.

Çështja 6 - Ndarja jo e duhur e detyrave

- E gjetura** Në kontratën “Blerja e lëndës djegëse – Dru” në vlerë 49,530€, dy nga tre anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave ishin caktuar edhe si organ mbikëqyrës të punëve/menaxher të kontratave.
- Ndërsa, sipas udhëzuesit operativ të prokurimit publik, parimet e ndarjes së detyrave, zyrtarët të cilët kanë qenë anëtarë të komisionit të vlerësimit nuk mund të caktohen menaxherë të projekteve.
- Kjo kishte ndodhur, si pasojë e kontrolleve jo adekuate në proceset prokuruese dhe përcjelljes së udhëzimeve nga udhëzuesin operativ i prokurimit.
- Rreziku** Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave rrit rrezikun se kontrollet e brendshme nuk janë adekuate.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të sigurojë se me rastin e formimit të komisioneve të ndryshme do të respektohen parimet për ndarjen e detyrave me qëllim që të evitohen konfliktet e mundshme të interesit.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 430,041€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 362,657€. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me shpenzimet e aktiviteve sportive kulturore, bursa, mbështetje të fermerëve, si dhe personave fizik si përfitues individual në gjendje të vështirë social-ekonomike.

Çështja 7 - Paguesa e pagave dhe mëditjeve nga kategoria e subvencioneve

- E gjetura** Nga kategoria e subvencioneve janë bërë tri⁶ pagesa në vlerë totale 1,648€, të cilat nuk parashihen në rregulloren e brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve, këto pagesa duhet të bëhen nga kategoria e pagave dhe shtesave.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve të duhura në respektimin rregullores së brendshme, bën që buxheti i ndarë për kategorinë e subvencioneve të mos shpenzohet për qëllimet e planifikuara dhe planet të mbesin të pa përmbushura.
- Rekomandimi 7** Kryetari, duhet të siguroj që pagesat për subvencione të jenë në harmoni me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe se pagesat nga kjo kategori të bëhen vetëm për pagesat që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

⁶ “Punë jashtë orari ” në vlerë 900€; “Kompensimi në rast të vdekjes së anëtarit të familjes” në vlerë 407€; dhe “Pensionim të parakohshëm” në vlerë 341€.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,689,428€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 2,935,774€, që kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale.

Çështja 8 - Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi

E gjetura Kuvendi Komunal kishte marrë vendim për realizimin e projektit “Ngritja e përkujdesit social, shtëpiak dhe ambulatorë Home-Care 2017” pasi që ky projekt nuk ishte i planifikuar me buxhet. Në mars 2017 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes organizatës jo qeveritare (OJQ) dhe komunës, në vlerë totale 240,000€. Bazuar në marrëveshje, komuna participon vlerën 222,819€ ndërsa OJQ-ja në vlerë 17,181€. Në marrëveshje ishte specifikuar që mjetet të transferohen në llogarinë e OJQ-së në dy këste, pastaj në fund të projektit të bëhet raporti final.

Pavarësisht se afro 93% e buxhetit financohet prej komunës, komuna ka transferuar buxhetin të OJQ duke bartur rreziqet për mosarritjen e objektivave.

Me tutje, gjatë testimit të shpenzimeve vërejtëm se projekti nuk është realizuar në përputhje me kërkesat (qëllimet) e përcaktuara. Përderisa fokusi i projektit do të duhej të ishin shërbimet shëndetësore, projekti ishte fokusuar kryesisht në sektorin e administratës dhe arsimit, duke kompensuar pagat për 60 të punësuar në këta sektor, ndërsa vetëm 32 punëmarrës janë kompensuar në sektorin shëndetësor.

Rreziku Transferimi i buxhetit pa mbikëqyrjen e projekteve në proces e sipër paraqet rrezik për mos realizimin e projekteve në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Rekomandimi 8 Kryetari, duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve, do të jenë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Po ashtu duhet siguruar se projektet në të ardhmen të realizohen në bazë të objektivave të parapara të programit.

Çështja 9 - Mbikëqyrja jo duhur e projekteve

- E gjetura** Sipas Udhëzuesit operativ të prokurimit publik⁷ "Ndarja e detyrave" do të thotë se autoriteti i një personi (ave) për të miratuar dhe për të nënshkruar miratimin në një fushë të përgjegjësisë nuk përfshinë edhe ato të një tjetër fushe të përgjegjësisë.
- Për kontratën "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sllatinë e Vogël, Graboc, Henc dhe Miradi e Epërme" në vlerë 104,262€ ishte formuar komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të projektit prej tre anëtareve. Po i njëjti komision kishte bërë edhe pranimin teknik të punëve.
- Rreziku** Mos pranimi teknik i punëve nga një komision i veçantë, i ndarë nga ai i mbikëqyrjes për realizimin e projektit, mund të rezultojë që pranimi i teknik punëve mos të bëhet sipas situacioneve/vlerës së kontraktuar.
- Rekomandimi 9** Kryetari, duhet të sigurojë se pranimi pranimi teknik të punëve të formohet sipas kërkesave të përcaktuara, në mënyrë që kontrollet e brendshme të jenë më efektive.

Çështja 10 - Mos aprovimi i ndryshimeve për pozicionet e caktuara në projekte

- E gjetura** Gjatë ekzaminimit fizikë të dy⁸ projekteve kemi konstatuar se gjendja në teren nuk përputhet në tërësi me specifikat e projektit dhe me raportin teknik të komisionit. Është konstatuar se gjatë punëve ka pasur devijime – ndryshime nga pozicionet e parapara me projekt. Në njërin projekt ndryshimet nga specifikacionin teknik ishin në vlerë prej 1,440€, ndërsa tek projekti tjetër ndryshimi i pozicioneve ishte në vlerë prej 600€. Këto ndryshime nuk janë prezantuar e as arsyetuar në raportin teknik të komisionit. Për më shumë, për ndryshimet e pozicioneve nuk kishte aprovim nga personat përgjegjës.
- Rreziku** Mos evidentimi i ndryshimeve gjatë realizimit të projekteve, rezulton se kontrollet e brendshme nuk janë adekuate, dhe nuk pasqyrojnë një gjendje reale të realizimit të projekteve sipas specifikave të përcaktuara.
- Rekomandimi 10** Kryetari, duhet të sigurojë se në raste të devijimeve nga projektet, të dokumentohen dhe arsyetohen devijimet në raportet e komisionit të pranimi teknik, mandej që ndryshimet eventuale të aprovohen.

⁷ Neni 62 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik

⁸ Projekti "Vendosja e ndriqimit publik-faza e dytë" ; Muzaferë Ramadani; Maja e Goleshit; Ismajl Shllamniku; Haxhi Zeka; Pellazgë; Naser Hajrizi (faza e dytë)", si dhe projekti "Furnizimi dhe montimi i dyerëve dhe dritareve në shkollën fillore të mesme të ulët - Laura Skoti në fshatin Graboc i poshtëm"

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Çështja 11 - Sfidat në inventarizimin e pasurisë

- E gjetura** Për inventarizimin e pasurisë jo financiare ishin formuar tri komisione. Komisionet kishin bërë inventarizimin e pasurisë për sektorin e administratës, arsimit dhe shëndetësisë, për secilin sektor ishin hartuar raporte të inventarizimit. Megjithatë nuk ishte bërë një raport i gjithëpërfshirës për të harmonizuar/krahasuar me regjistrat e pasurisë.
- Rreziku** Mos përgatitja e një raporti gjithëpërfshirës, rrezikon që regjistri i pasurisë të mos jetë i plotë dhe të rezultojë me pasaktësi.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë që komisioni të hartojë raportin gjithëpërfshirës në mënyrë që regjistri i pasurisë të jetë i plotë dhe i saktë.

Çështja 12 - Mos definimi i statusit për shfrytëzim pronësor

- E gjetura** Komuna në vitin 2017 kishte vazhduar punimet për ndërtimin e 36 shtëpive për raste sociale të filluara në vitin 2015. Prej tyre, 16 shtëpi ishin përfunduar, ndërsa 20 shtëpi ende janë të pa përfunduara.
- Ndërtimi i shtëpive ishte bërë në tokat private të përfituesve, në përjashtim të dy rasteve ku shtëpitë ishin ndërtuar në pronën publike. Megjithatë, nuk ishin përcaktuar me ndonjë marrëveshje mirëkuptimi të drejtat dhe obligimet ligjore në lidhje me to, sidomos kur është fjala për posedimin e shtëpive nga përfituesit në pronën komunale.
- Rreziku** Mos sqarimi i statusit (të drejtave dhe obligimeve) për shtëpi mund të krijoj probleme ligjore apo konteste gjyqësore, si për komunën, ashtu edhe për shfrytëzuesit e tyre.
- Rekomandimi 12** Kryetari, duhet të sigurohet që në raste të tilla të definohet dhe rregullohet statusi i këtyre pronave/shtëpive, dhe të lidhen marrëveshje të vlefshme në mes të komunës dhe secilit shfrytëzues, ku definohen të gjitha të drejtat dhe obligimet e secilës palë.

3.9 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësave më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Të arkëtueshmet

Komuna ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar përmes drejtorive përkatëse.

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishin në vlerë prej 3,032,173€, në këtë shumë janë të përfshira të arkëtueshmet nga: tatimi në pronë, qiraja nga objektet publike, të hyrat nga shitja e pasurisë, taksat për ushtrimin e veprimtarisë, leje ndërtimi, dhe qiraja nga objektet e banimit në Miradinë e Epërme.

Krahasuar me vitin 2016 llogaritë e arkëtueshme janë zvogëluar, për shkak se Kuvendi Komunal kishte marrë vendim që të mos faturohen bizneset-për taksat e ushtrimit të veprimtarisë. Po ashtu në zvogëlim kishte ndikuar edhe falja e borxheve të tatimit në pronë. Tatimi në pronë i faturuar për vitin 2017 ishte në vlerë prej 700,257€, derisa ishte inkasuar vetëm 317,777€ apo 45%.

Çështja 13 – Sfidat në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

E gjetura Vlerat e larta të llogarive të arkëtueshme mbeten sfidë për komunën. Pjesa me e madhe e tyre janë të arkëtueshme të vjetra nga vitet paraprake. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrë shkaktarët e mos mbledhjes së borxheve ka rezultuar me një inkasim të dobët të tyre.

Rreziku Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pambledhshme duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën. Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, numrin e projekteve potenciale që do të financoheshin nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi 13 Kryetari, duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 145,837€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja 14 - Mos shpalosja e obligimeve në pasqyrat financiare

E gjetura Komuna nuk ka kompensuar arsimtarët për orët e punuara mbi normë dhe obligimet e mbetura nuk janë shpalosur në PFV, si:

- Sipas zyrtarëve, numri i nxënësve në komunën e Fushë Kosovës është rritur viteve të fundit. Në pamundësi të shtimit të numrit të stafit-arsimtarëve, komuna kishte angazhuar arsimtarët ekzistues që të mbajnë orë shtesë (honorar). Obligimet e mbetura për pagesën e orëve të mbetura ishin në vlerë 15,537€; dhe
- Për më tutje, në drejtorinë e arsimit ishin pensionuar shtatë punëtorë, mirëpo pagat përcjellëse të pensionit nuk ju kishin paguar. Obligimet për këta pensionistë kapin vlerën prej 10,211€.

Përveç kësaj në pesë raste faturat /obligimet nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve.

Rreziku Dështimet e pagesave ndaj arsimtarëve dhe pensionistëve në afatet ligjore, rritë rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyej obligimet e vitit paraprak. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë edhe me padë gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari.

Rekomandimi 14 Kryetari, duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtoj obligimet e mbetura me MF dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e obligimeve. Me tutje të caktoj politika konkrete për t'i kryer obligimet me kohë sipas afatit të paraparë ligjor, në mënyrë që të parandalojë hyrjen në obligime të reja.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të komunës ka rezultuar në 19 rekomandime. Komuna, kishte përgatitur një Plan Veprimi me vonesë ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, pesë rekomandime janë zbatuar, shtatë ishin në proces ndërsa shtatë nuk janë zbatuar ende. Ndërkaq, në vitin 2015 janë dhënë 14 rekomandime, prej tyre, një është zbatuar, katër rekomandime janë në procese të zbatimit ndërsa nëntë nuk ishin trajtuar ende nga ana e menaxhmentit.

Kryetari i Komunës ka shqyrtuar raportin e auditimit për vitin 2016 në Asamblenë Komunale, mirëpo nuk ka prezantuar progresin lidhur me zbatimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit para se PFV-të të dorëzohen në MF-së.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 15 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Komuna edhe pse ka hartuar një plan veprimi (me vonesë), megjithatë, kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen.

Si pasojë, disa prej rekomandimeve si: keq klasifikimi i shpenzimeve, çështja e plotësisë së regjistrave të pasurisë, mungesa e regjistrimit të rreziqeve, mos ripërtëritja e kontratave të shfrytëzuesëve të pronave komunale, menaxhimi jo i duhur i obligimeve, si dhe rritja e llogarive të arkëtueshme janë të gjetura të përsëritura në raportet e auditimit në vitet e fundit.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 15 Kryetari, duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të përpilohet me kohë, të monitorohet në vazhdimësi dhe të raportohet në baza të rregullta tremujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse komuna ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Trendi i ulët i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake, mbetet sfidë e menaxhmentit, andaj duhet të marrin masa përmirësuese në këtë drejtim. Ekzekutimi i ulët i buxhetit në investime kapitale, angazhime të kufizuara në menaxhimin e rreziqeve dhe kontrolleve tjera të brendshme, si dhe programi i papërfunduar nga NjAB-së, zvogëlon sigurinë në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare.

Komuna, kishte plotësuar pyetësorin e vet-vlerësimit (pyetësori ishte mbështetur me dëshmi), mirëpo procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur.

Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit socio-ekonomik lokal konsiderohet se është e vendosur nga ana e komunës si dhe aprovimet e disa planeve tjera, të aprovuara nga Kuvendi Komunal: Plani i integritetit për vitin 2017-2019, Plani i punës së për vitin 2017, si dhe Plani zhvillimor i arsimit 2017-2019.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në komunë është e themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) e cila operon me dy auditor. NJAB në komunë, për vitin 2017 kishte planifikuar gjashtë auditime. Planet ishin bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve.

Çështja 16 – Mos përmbushja e planit vjetorë të Auditimit

E gjetura Nga gjashtë auditimet e planifikuara nga NjAB për vitin 2017, vetëm tri prej tyre janë përfunduar. Kryerja e pjesërishme e planit të auditimit të brendshëm, ishte si pasojë e menaxhimit jo efektiv të aktiviteteve nga NjAB.

Rreziku Programi i papërfunduar i NjAB-së, zvogëlon sigurinë në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Mungesa e aktiviteteve efektive të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që t'i identifikojë dobësitë e kontrolleve dhe të reagojë me kohë për eliminimin e tyre.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale, e njëkohësisht të përmbushen edhe objektivat e planifikuara në planin vjetor të punës.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ende kërkojnë përmirësim.

Çështja 17 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në menaxhimin e shpenzimeve duke i klasifikuar në kode adekuate, menaxhimin e kontratave për projekte kapitale, trajtimin e obligimeve të papaguara dhe pagesën e tyre me kohë, si dhe veprime konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Komuna, nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së dhe raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 17 Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve parapra

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënëse për keq klasifikim të shpenzimeve dhe shpalosjen e pasurive. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVFve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet nga viti i kaluar	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar me adresimin e rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave.		Janë përgatitur plani strategjik dhe disa plane tjera operative, mirëpo ende nuk është hartuar plani për menaxhimin e rrezikut.	

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se identifikimi, vlerësimi i rrezikut dhe masat për reduktimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, shqyrtohen në nivelet më të larta të menaxhmentit. Më tej, duhet të sigurohet se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësisve do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme dhe efektive.		Komuna ka përmirësuar raportimin tek shpenzimet për mallra dhe shërbime, specifikimi (ndarja) e obligimeve, megjithatë, ende ka hapësirë për përmirësime, si: keq-klasifikimet, regjistrimi i pasurive, menaxhimi i projekteve kapitale etj.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se Sistemi i auditimit të brendshëm vepron në mënyrë efektive, me fokus parësor në fushat ku rreziqet vlerësohet të jenë të larta dhe se rishikimet trajtojnë çështjet/aktivitetet e vitit aktual. Si fusha me prioritet për auditim mund të jenë: të hyrat vetjake, dhënia e subvencioneve, keq klasifikimet e shpenzimeve që po përsëriten për vite me radhë, etj. Komiteti i auditimit, gjithashtu, duhet të bëj një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.		Në raportet e NJAB-së janë dhënë rekomandime në disa fusha të rëndësishme, megjithatë, mos përmbyshja e planit të NjAB-së, tregon se ende është sfiduese kjo fushë.	
3.3. Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.			Nuk janë marrë masa.

3.4 Prokurim	Kryetari duhet të siguroj se në tabelat buxhetore për Investime Kapitale të vendosen vetëm ato projekte që janë të natyrës kapitale. Më tej, të kryhet një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e përmendura, dhe mangësitë e njëjta të mos përsëriten në të ardhmen.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet financiare mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve financiare fuqizohen për të siguruar se të gjitha shpenzimet realizohen duke u bazuar në ligjin e buxhetit dhe rregulloret përkatëse.	Po		
	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen, do të jetë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Praktikrat e tilla të financimit dhe pagesat e bëra në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të ndërpriten, dhe në vend të kësaj të insistohet që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas pranimin të shërbimeve dhe të bazuara në fatura dhe në bazë të progresit të marrëveshjeve, dhe jo në formë paradhënie.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet (paga dhe mëditjet)	Kryetari duhet të siguroj se shpenzimet bëhen konform ndarjeve buxhetore dhe se asnjë shpenzim nuk do të bëhet nga kategoria e mallrave/shërbimeve dhe subvencione për kategorinë e pagave dhe mëditjeve.			Nuk janë marrë masa.

3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të nxis departamentet përkatëse të komunës që të zbatojnë në mënyrë strikte kërkesat e dispozitave kontraktuese ndaj personave që u janë shitur pronat apo të cilëve këto prona u janë dhënë në shfrytëzim me qira. Po ashtu, një çasje e përmirësuar e planifikimit të të hyrave mund të aplikohet duke marrë në konsiderim analizën e trendit gjatë viteve të fundit, dhe bazën aktuale të ngarkesave të tatimit në pronë dhe ndërtimeve potenciale. Çështje shqyrtimi, duhet të jetë edhe ndërtimi i strategjisë dhe mekanizmave efikas për inkasimin e borxheve nga taksat e biznesit, duke mos përjashtuar edhe masat administrative (nëse ka nevojë).			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Përkundër vlerësimit tonë për punën e komisionit, ne rekomandojmë që Kryetari duhet të siguroj që regjistri i pasurisë mbi 1,000€ përmban vetëm pasuritë që janë në pronësi të komunës, dhe procesi i regjistrimit të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar të të gjitha pasurive.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të sigurojë iniciimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim.		Në raport me vitin 2016 të arkëtueshmet janë më të ulëta, mirëpo ende nuk kishin analizuar vjetërsinë e borxheve dhe mundësive reale për inkasim.	

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Procesi buxhetor duhet të jetë reflektim i shpenzimeve reale në mënyrë që të gjitha shpenzimet të klasifikohen sipas kodeve adekuate. Gjithashtu, para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato duhet t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar, dhe të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen në tërësi. Për ta përmirësuar procesin, raportet e progresit në zbatimin e rekomandimeve duhet të shqyrtohen çdo tremujor dhe mekanizmi i llogaridhënies duhet të vendoset.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës së rreziqeve, përmirësimin e planifikimeve buxhetore për të evituar keq klasifikimin e shpenzimeve dhe adresimin e fushave tjera ku janë identifikuar dobësitë.			Nuk janë marrë masa.
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të siguroj hartimin e planeve operative, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së rezultateve kundrejt objektivave dhe të vendos procese efektive të mbikëqyrjes.		Komuna ka arritur të hartojë vetëm disa nga planet operative, megjithatë mbetet që të hartojë planet për të gjitha njësitë organizative.	

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve menaxheriale dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrolle të përshtatshme, në fushat ku janë identifikuar dobësitë.		Komuna ka përmirësuar raportimin tek PFV-të si dhe të raportimi i obligimeve, megjithatë, ende ka fusha ku kërkohen përmirësime, si keq klasifikimet, regjistrimi i pasurive, dhe menaxhimi i projekteve kapitale.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për rekomandimet e AB, dhe të kërkoj nga bartësit përgjegjës ku janë dhënë rekomandimet, që në mënyrë formale të raportojnë mbi zbatimin e tyre, të siguroj se NJAB fokuson rishikimet e saj në fushat që përmbajnë një shkallë të lartë të rreziqeve operative dhe, komiteti i auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj temat që do t'i trajtoj me prioritet gjatë vitit.		Në raportet e NJAB-së janë dhënë rekomandime në disa fusha të rëndësishme, si dhe menaxhmenti kishte filluar të përgatisë plane të veprimit, mirepo plani vjetor i punës nga auditori i brendshëm ende nuk ka arritur të realizohet.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet që secili objekt të inspektohet, të sigurohet që mos të ndërtohen objekte para se të pajisen me lejet përkatëse në pajtim me ligjin mbi ndërtimin dhe sipas kushteve ndërtimore urbanistike, dhe të hyrat të inkasohen sipas planifikimit dhe rregullores mbi tarifën dhe ngarkesat.	Po		
	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimi i buxhetit për vitin vijues të jetë i bazuar në inkasimet e vitit aktual, në mënyrë që të hyrat të jenë konform planifikimit dhe pritshmërisë së inkasimit. Komuna duhet të bëjë plan konkret për të minimizuar borxhet e akumuluar nga 2003. Tatimpaguesit të cilët paguajnë borxhet sipas ligjit, të fshihen nga regjistrat e komunës për borxhet e akumuluar dhe lista të përditësohet deri në fund të vitit 2017, si dhe në baza vjetore të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave të komunës.			Nuk janë marrë masa.

	Kryetari duhet të sigurohet që të bëhet një plan për inkasimin e të hyrave nga taksat e biznesit, duke faturuar çdo biznes në baza të rregullta mujore, të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive që ushtrojnë veprimtari dhe të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmëve të akumuluar ndërsa vite.		Nga kuvendi komunal ishte marrë vendim që bizneset të mos faturohen, mirëpo ende mbete sfidë menaxhimi i të arkëtueshmeve duke u bazuar edhe në rritjen e tyre nga viti i kaluar.	
	Kryetari duhet të marr masat për t'i pajisur qiramarrësit me kontrata në mënyrë që të kenë bazë ligjore të shfrytëzimit të pronave të saj, dhe të shqyrtoj mundësitë reale për trajtimin e borxheve të mbetura nga qiratë. Në të kundërtën, pronat publike duhet t'i rikthehen në zotërim të plotë komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Paga dhe Mëditjet	Kryetari duhet të rishikoj rastet për të cilat janë angazhuar mësimdhënësit dhe të konsideroj nëse angazhimet e tilla janë të përshtatshme për pozitat e caktuara. Në anën tjetër, të sigurohet se tatimet dhe kontributet janë paguar sipas ligjit në fuqi për tatimin në të ardhura personale.		Tatimet dhe kontributet nuk janë paguar sipas ligjit në fuqi për tatimin në të ardhura personale, mirëpo në vitin 2018 është duke u zbatuar.	
3.1.3 Mallra dhe Shërbime, si dhe shërbimet komunale	Kryetari i komunës duhet të sigurohet se të gjitha pagesat kryhet vetëm atëherë kur të jenë aplikuar proceset e rregullta të prokurimit dhe të jenë përmbushë kërkesat ligjore për shpenzimet e parasë publike.	Po		
	Kryetari duhet të rishikoj funksionimet e kontrolleve të brendshme për shpenzimet e parasë publike, dhe të siguroj se me rastin e procedimit të pagesave janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore.	Po		
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që pagesat për subvencione të jenë në harmoni me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe se pagesat nga kjo kategori të bëhen vetëm për pagesat që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.			Nuk janë marrë masa.

3.1.5 Investime kapitale	Kryetari duhet të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të nenit tetë (8) LPP, ku kërkohet që të vlerësohen nevojat vjetore për shpenzime sipas buxhetit dhe projekteve të planifikuara, përkatësisht të aprovuara.	Po		
	Kryetari duhet të rishikoj pse në rastin më sipër nuk janë zbatuar kërkesat e prokurimit dhe siguroj që në të ardhmen zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE e përgjegjshëm.	Po		
3.2 Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet që të formojë procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë, përfshirjen e gjitha pasurive në regjistrat e pasurisë dhe kompletimit të inventarizimit, duke hartuar edhe raportin gjithëpërfshirës për pasurinë jo financiare.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Llogarite e arkëtueshme	Për të ndërtuar një pasqyrë të plotë mbi llogaritë e arkëtueshme të komunës, Kryetari duhet të siguroj vendosjen e procedurave të brendshme për raportim të qartë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme dhe të aplikoj ligjin për faljen e borxheve.		Në raport me vitin 2016 të arkëtueshmet janë më të ulëta, mirëpo ende nuk kishin analizuar vjetërsinë e borxheve dhe mundësive reale për inkasim.	
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet që t'i marr masat e duhura me kohë për planifikim të buxhetit për t'i kryer obligimet e mbetura si dhe të caktoj politika efektive për parandalimin e hyrjeve në obligime të reja. Detyrimet financiare duhet të paraqiten në PVF vetëm atëherë kur pranohet fatura në komunë, ndërkaq obligimet kontraktuese duhet të shpalosen veçmas.		Vonesat në kryerjen e obligimeve të papaguara ende mbetet sfidë në komunë, derisa raportimi (shpalosja) e tyre ka shënuar progres.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË – KOSOVË , KOSOVO POLJE

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Fushë Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. **Burim Berisha**.....

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës,

Data: 12. qershor.2018, Fushë Kosovë,